

UDHËZIM
Nr. 8, datë 23.6.2014

MBI PËRLLLOGARITJEN E PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE, NË ZONAT PILOT

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në zbatim të pikës 12, të vendimit nr. 904, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot”,

UDHËZOJ:

1. Drejtoria rajonale pas vlerësimit sipas sistemit të pikëzimit për familjarët dhe individët në qarkun e Tiranës, Elbasanit dhe Durrësit, llogarit masën e ndihmës ekonomike.

2. Pavarësisht nga përbërja e saj, masa maksimale e plotë e ndihmës ekonomike për familjen nuk mund të jetë më e lartë se 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj.

3. Masa e ndihmës ekonomike, në muaj, për prindërit e fëmijëve të lindur:

- a) trinjakë, është 3 000 (tre mijë) lekë për çdo fëmijë;
- b) katërnjakë, është 4 000 (katër mijë) lekë për çdo fëmijë;
- c) pesënjakë, është 5 000 (pesë mijë) lekë për çdo fëmijë.

4. Masa e ndihmës ekonomike për viktimat e trafikimit është 3000 (tre mijë) lekë në muaj dhe përfitohet pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre.

5. Masa e ndihmës ekonomike për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore, është 3000 (tre mijë) lekë në muaj. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet gjatë periudhës së vlefshmërisë të urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të përcaktuar në vendimin e gjykatës.

6. Masa e ndihmës ekonomike për familje llogaritet:

a) 1800 lekë, për anëtarin e parë të familjes sipas renditjes në certifikatën familjare;

b) 1260 lekë, për anëtarët e tjerë të familjes mbi moshën 18 vjeç;

c) 900 lekë për anëtarët që janë në dhe nën moshën 18 vjeç.

7. Për rastet kur familja e përzgjedhur për të përfituar ndihmë ekonomike, është e përbërë vetëm nga një anëtar, i cili është mbi moshë pune, masa e ndihmës ekonomike është 2.600 lekë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

Erion Veliaj